Ai që del për të kërkuar dituri është në rrugën e Allahut derisa të kthehet

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ka thënë : "Ai që del për të kërkuar dituri është në rrugën e Allahut derisa të kthehet."
[Hadith hasen] [E shënon Tirmidhiu]

Kuptimi është: ai që del prej shtëpisë a vendit të tij duke kërkuar dije fetare, e ka vendimin si të atij që del për të bërë xhihad në rrugë të Allahut të Lartësuar, derisa të kthehet te familja e tij, për faktin se i tilli është sikurse muxhahidi, sa i përket gjallërimit të fesë, përçmimit të shejtanit dhe lodhjes së vetes.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/4191